



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

KESHILLI BASHKIAK BELSH

Nr--Prot

Belsh më 27/ 12 / 2024

PROCES-VERBAL

“I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 27.12.2024”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

Janë prezent në mbledhje 17 këshilltarë:

1. Bujar Blloku
2. Erion Qafa
3. Nertila Uruçi
4. Blerim Kuqja
5. Ramis Uruçi
6. Fadil Zdrava
7. Aleksander Peqini
8. Nexhip Elelzi
9. Naime Ibrahim
10. Gezim Gjoshi
11. Erion Gjoshi
12. Gazeli Hysa
13. Ismail Paja
14. Aurela Hysa
15. Aurjola Bezati
16. Enkeleda Kullolli
17. Kujtim Dervishi

- Kryetari i keshillit bashkiak z.Kujtim Dervishi hap mbledhjen e këshillit bashkiak dhe propozon shtesën e 2 projekt vendimeve të ardhura nga Drejtoria e Financës, miratohet propzimi me 11 vota pro,4 kundër dhe 1 abstenim.

- Kalojmë te pika 1 e rendit të ditës për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, mbron Ditjon Pepa.
- I.Paja: Sa % është mbledhur taksa e tokës dhe banesës?
- D.Pepa: Rreth 50 %.
- Merr pjesë në mbledhje edhe kryetari i bashkisë Arif Tafani.
- R.Uruçi: Do rriten të ardhurat me këto zbritje të taksave?
- D.Pepa: Ndryshimet janë parashikuar në ligj dhe nuk janë propozim i zyrës.
- B.Kuqja: Propozoj që taksat e biznesit të jenë 20% më pak se ato të vitit aktual.
- A.Tafani: Bashkia Belsh ka kontratën më të ulët për pastrimin në raport me të gjitha bashkitë e republikës.
- Hidhet në votim projekt-vendimi dhe miratohet me 12 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.2 e rendit të ditës ,për numrin total të punonjësve dhe institucioneve në vartësi.
- Hidhet në votim dhe kalon me 11 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.3 e rendit të ditës.
- Propozon N.Uruçi që shpërblimi të jëtë 5% për kryetarët e fshatrave.
- Kalon pika nr.3 me 12 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.4 për normativen e harxhimit të karburantit.Prezanton A.Nipolli.
- A.Nipolli: Normat janë të njëjta me vitin e kaluar.
- K.Dervishi: Kërkojmë informacion në lidhje me karburantin e harxhuar.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 12 vota pro dhe 5 kundër.
- Kalojmë te pika nr.10 për miratimin e bursave të nxënësve. Prezanton O.Nipolli.
- Hidhet në votim pika nr.10 dhe miratohet me 17 vota pro.

- Kalojmë te pika nr.5, Për nivelin e pagave të punonjësve.
- N.Uruçi: Propozoj që punonjësit e shërbimeve të marrin maksimalen e pagës.
- Nuk miratohet me 6 vota pro dhe 11 kundër propozimi i N.Uruçi.
- Hidhet në votim p/vendimi dhe miratohet me 11 vota pro,5 kundër dhe 1 abstenim.
- Kalojmë te pika nr.6 ,për kuotën e Këshillit të Qarkut
- Kalon me 17 vota pro pika nr.6.
- Kalojmë te shtesa nr.1 e rendit të ditës ,për miratimin e shtesës së buxhetit për vitin 2024.
- Nga diskutimet ,K.Dervishi: Propozoj që të gjitha varrezat të lidhen me ujë të pijshëm.
- Hidhet në votim dhe kalon me 17 vota pro.
- Kalojmë në shtesën nr.2 në rendin e ditës ,për nxjerrje jasht përdorimit të materialeve.
- Hidhet në votim dhe kalon me 14 vota pro,1 kundër,2 abstenim.
- Kalojmë te pika nr.7 për Buxhetin 2025, prezanton Alban Nipolli.
- B.Kuqja : Ne kemi sjellë propozimet tona si grup këshilltarësh.
- I.Paja : Shpenzimet gjyqësore pse janë planifikuar?
- A.Nipolli : Janë shpenzime për gjyqet që kanë nisur pronarët e objekteve që janë shëmbur nga projekti “Ansambli i Rilindjes Urbane”.
- I.Paja : Përse nuk është blerë koshi me vinç?
- A.Nipolli : Nuk ka qënë e nevojshme.
- K.Dervishi : Kalojmë te propozimi i këshilltarëve të PD-së.
- Prezanton Blerim Kuqja propozimin e grupit të këshilltarëve.
- N.Uruçi : Propozimet tona janë në shërbim të qytetarëve.
- Hidhet në votim propozimi i grupit të PD-së dhe nuk kalon me 6 vota pro dhe 11 kundër.

- Hidhet në votim pika nr.7 për “Buxhetin” dhe kalon me 11 vota pro dhe 6 kundër.
(Largohen nga mbledhja 5 këshilltarët e opozitës)
- Kalojmë te pika nr.8, për “ Prioritet Investimi”,prezanton N.Reka.
- I.Paja : Kërkoj informacion për çdo rrugë.
- Kalojmë te pika nr.9 për miratin e vlerës së bonusit sipas qirave mesatare në treg.
- Hidhet në votim dhe kalon me 11 vota pro dhe 1 kundër.
- Kalojmë te pika nr.11 për miratim kontrate me Eco-Elb,hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro dhe 1 kundër.
- Kalojmë në pikën e fundit për “Miratimin e Planit të Punës së Këshillit Bashkiak” dhe miratohet me 11 vota pro.
- A.Bezati : Kërkoj informacion në lidhje me znj.Shkëndi Gjolena për një problem në lidhje me tokat.

Mbyllet mbledhja e këshillit me 14 vendime të miratuara.

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA